

UDHËZIM
Nr. 21, datë 1.6.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 15.6.2015 "PËR
PROCEDURAT DHE KRITERET E FURNIZIMIT TË ANIJEVE TË PESHKIMIT
ME KARBURANT (GAZOIL), ME PËRJASHTIM NGA TAKSA E QARKULLIMIT,
TAKSA E KARBONIT DHE AKCIZA"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 14.1.2015, "Për përcaktimin e procedurave, të sasive, të kushteve dhe të kriterëve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit", ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 18, datë 15.6.2015, "Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil), me përjashtim nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pjesën hyrëse, baza ligjore, "*ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar' dhe 'vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, 'Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor', të ndryshuar*", zëvendësohet respektivisht me bazën ligjore "*ligjit nr. 102, datë 31.7.2014, 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar' dhe 'vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, 'Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor', të ndryshuar*".

2. Kudo ku përmendet termi "*magazina të lira*" zëvendësohet me termin "*zona të lira*".

3. Në pikën 29, baza ligjore "*ligjin nr. 8449, datë 27.1.1999, 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar*", zëvendësohet me bazën ligjore "*ligjin nr. 102, datë 31.7.2014, 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar*".

4. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3.1 Ngjyroja e karburantit (gazoilit) për peshkim kryhet sipas modaliteteve të operacioneve të denatyrimit, të përcaktuara në aneksin 18, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 5.9.2012."

5. Në shtojcën 2, paragrafi:

"Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 5.9.2012, 'Për dispozitat zbatuese të ligjit 'Për akcizat', të ndryshuar, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 14.1.2015, 'Për përcaktimin e procedurave, të sasive, kushteve dhe kriterëve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga akciza, taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit' dhe të udhëzimit nr. __, datë ____ 2015, subjekti i peshkimit ____ kërkon të furnizohet me gazoil për peshkimin për anijen e peshkimit ____, në sasinë prej ____ (sasia në fjalë) litra. Ky furnizim do të kryhet me datë _____.20____, pranë magazinës suaj, në orën _____.", zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

"Mbështetur në ligjin nr. 102, datë 31.7.2014, 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, 'Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor', i ndryshuar; në ligjin nr. 61/2012, datë 24.5.2012, 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 5.9.2012, 'Për dispozitat zbatuese të ligjit 'Për akcizat', i ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 14.1.2015, 'Për përcaktimin e procedurave, të sasive, kushteve dhe kriterëve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga akciza, taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit' dhe në udhëzimin nr. 18, datë 15.6.2015, i ndryshuar, subjekti i peshkimit kërkon të furnizohet me gazoil për peshkimin për anijen e peshkimit, në sasinë prej ____ (sasia në fjalë) litra.

Ky furnizim do të kryhet në datën _____.20____, pranë magazinës suaj, në orën ____:____."

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Anila Denaj

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi